



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca Plenare e Kuvendit të Kosovës
Senca nr.2003/4
Prishtinë, më 13 shkurt 2003, ora 10:15
Ndërtesa e Kuvendit, salla plenare

PROCESVERBAL

Seancën e kryesoi z.Nexhat Daci, kryetar i Kuvendit të Kosovës, kurse bashkëkryesues ishte z. Hydajet Hyseni, anëtar i Kryesisë.
Kryesusi konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 104 deputetë dhe deklaroi të hapur punën e saj.

Për këtë seancë u propozua ky

RENDI DITËS:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga seanca e kaluar;
3. Shqyrtimi i parë i P/Ligjit "Për Likuidimin dhe Riorganizimin e Personave Juridikë në Bankrotim-2003/2";
4. Shqyrtimi i parë i P/Ligjit "Për Farërat-2003/1";
5. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit "Për Pyjet e Kosovës-2002/10"; dhe
6. Parashtrimi i pyetjeve.

1. Miratimi i rendit të ditës.

Kryesuesi i informoi deputetët me iniciativën e 42 deputetëve që kanë kërkuar nga Kryesia e Kuvendit që të thërras seancën e jashtzakonshme të Kuvendit për të miratuar Deklaratën për shpalljen e Kosovës shtet sovran dhe të pavarur. Kryesia e Kuvendit, tha kryesusi, ka

proceduar me propozimin e rendit të ditës për seancë të rregulltë. Në ndërkohë, kryetarët e grupeve parlamentare të LDK-së, PDK-së, AAK-së dhe të grupeve etnike joserbe i kanë harmonizuar qëndrimet lidhur me këtë çështje dhe e ftoi z. Hydajet Hyseni që t'i paraqesë qëndrimet e tyre.

Hydajet Hyseni e lexoi deklaratën e përbashkët të grupeve parlamentare të LDK-së, PDK-së, AAK-së dhe të minoritetve të tjera në lidhje me nismën e deputetëve të Kuvendit të Kosovës për miratimin e Deklaratës për Kosovën Shtet sovran dhe të pavarur të datës 3 shkurt 2003.

Grupet parlamentare në Kuvendin e Kosovës, shtoi z. Hyseni u pajtuan me sa vijon:

Përkrahin nismën e deputetëve të Kuvendit të Kosovës për miratimin e Deklaratës për Kosovën shtet sovran dhe të pavarur, të datës 3 shkurt 2003.

2 Nisma e deputetëve ka hyrë në procedurë të rregullt në Kuvendin e Kosovës dhe vazhdon shqyrtimi i saj.

Kryetarët e grupeve parlamentare marrin përsipër harmonizimin e qëndrimeve për Deklaratën e Pavarësisë me grupet parlamentare dhe me institucionet e tjera të pushtetit në Kosovë.

Deklarata e harmonizuar do të dalë për miratim në ndonjërin nga seancat e ardhshme të Kuvendit të Kosovës në procedurë të rregullt në bashkëpunim të kryetarëve të grupeve parlamentare dhe të Kryesisë së Kuvendit.

Deklaratën e kishin nënshkruar, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së- Sabri Hamiti, të Grupit Parlamentar të PDK-së- Fatmir Limaj, të Grupit Parlamentar të AAK-së- Bujar Dugolli dhe në emër të Grupi Parlamentar të minoriteteve të tjera- Zylfi Merxha.

Muhamed Kelmendi tha se i përkrah qëndrimet e grupeve parlamentare lidhur me Deklaratën që e lexoi z. Hyseni, por ai kishte vërejtje në procedurën e saj për tri çështje: a) Deklarata nuk është nismë, por kërkesë e 43 deputetëve të Kuvendit; b) shqyrtimi i saj duhet të bëhet nga ana e deputetëve në seancë; dhe c) Kuvendi i Kosovës dhe as Kryesia e Kuvendit nuk kanë të drejtë që të mos e vënë në rend të ditës këtë çështje.

Kuvendi i Kosovës, shtoi z. Kelmendi, ka tri forma të vendosjes: a) të shpallë pavarësinë; b) ta refuzojë atë; dhe c) t'i pranojë rezultatet e Referendumit të vitit 1992. Ai kërkoi që lidhur me këtë çështje, lirisht të vendosin deputetët e Kuvendit.

Pasi nuk pati diskutime të tjera, kryesusi konstatoi se u miratua rendi i ditës.

2. Miratimi i proçesverbalit të seancës së kaluar.

Deputeti Mahmut Bakalli pati vërejtje se nuk kishte hyrë edhe emri i tij në debatin e zhilluar lidhur me çështjen e sigurisë në Kosovë. Me këtë vërejtje u miartua proçesverbali i seancës së kaluar.

3. Shqyrtimi i parë i P/Ligjit "Për Likuidimin dhe Riorganizimin e Personave Juridikë në Bankrotim-2003/2".